

VENDIM
Nr. 205, datë 13.9.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË
RINOVUESHME NGA DIELLI, ME FUQI TË INSTALUAR DERI 2 mw DHE ERA,
ME FUQI TË INSTALUAR DERI
3 mw PËR VITIN 2018**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2 nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenet 19, 20, 21 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 13.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar deri 2 mw dhe era, me fuqi të instaluar deri mw për vitin 2018,

konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 10, pika 2; dhe 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, me fuqi të instaluar respektivisht 2 mw dhe 3 mw.

- VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

- Pika 2 e vendimit nr. 120, datë 27.7.2017, të Bordit të ERE-s, i cili miratoi çmimet për prodhuesit e vegjël nga dielli dhe era për vitin 2017 përcakton se “Duke filluar nga viti 2018, për investimet në vijim, ERE, në bazë të grumbullimit të të dhënave, për sa u përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, t’i propozojë MEI-t për përmirësimin dhe rishikimin e VKM-së”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar deri 2 mw dhe era, me fuqi të instaluar deri 3 mw për vitin 2018.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti